



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**

Në bazë të nenit 15 dhe nenit 33 të Ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003/30, të nenit 11 të Ligjit për ndryshimin e Ligjit për planifikimin hapësinor 2003/14, nr. 03/L - 106 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 42/2008), të nenit 17 dhe nenit 58 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L - 040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), të nenit 16, pika 16. 1, shkronja **b**, nenit 32, pika 32.1, shkronja **e** dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 455, të dt. 31.3.2008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 23.7.2009, merr

**V E N D I M**  
**PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT RREGULLUES**  
**"TASLIXHE" NË PRISHTINË**

**Neni 1**

Miratohet Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues "Taslixhe" në Prishtinë.

**Neni 2**

Qëllimi i nxjerrjes së Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, është rregullimi i hapësirës dhe urbanizimi, sipas destinimeve të planifikuara me Planin strategjik-zhvillimi urban i Prishtinës, i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01-031-1231/1, të dt. 2.7.2004, brenda kufijve të përshkruar në nenin 3 të këtij Vendimi.

**Neni 3**

Me Planin rregullues nga neni 1 i këtij Vendimi, do të përpunohet pjesa e territorit të qytetit të Prishtinës e emërtuar "Taslixhe", e cila nga ana perëndimore përkufizohet me rr. "Fan Noli", vazhdon përgjatë rr. "Rasim Kiqina", rr. "Mehmet Hakif Ersoi", rr. "Naser Hajrizi", rr. "Onufri", duke u takuar me territorin e lagjes Sefalia, duke vazhduar me rr. "Shpëtim Rrobaj", përgjatë parkut "Taukbahçe" në drejtim të rrugës "Nazim Gafurri", duke u përmyllur te udhëkryqi i rrugës "Fan Noli", me sipërfaqe prej 23.5 ha. Kufijtë e hapësirës të përshkruar në par. 1 të këtij neni, janë të paraqitur në pjesën grafike, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

**Neni 4**

Bartësi i detyrave programore dhe i hartimit të Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, do të përcaktohet përmes procedurës së tenderimit. Drejtoritë tjera të Komunës së Prishtinës janë të obliguara që të sigurojnë dhe t'i dërgojnë shënimet e kërkuara nga Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, të cilat konsiderohen të jenë të nevojshme për hartimin e Planit rregullues sipas këtij Vendimi.

### **Neni 5**

Mjetet financiare për hartimin e Planit Rregullues, sipas këtij Vendimi, do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Prishtinës.

### **Neni 6**

Plani rregullues, sipas këtij Vendimi, do të miratohet me Vendimin e Komunës së Prishtinës si projektplan, në mënyrë që ai t'i nënshtrohet diskutimit publik para finalizimit dhe miratimit përfundimtar të tij.

### **Neni 7**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunes dhe Drejtorja e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit të Komunës së Prishtinës. Organet tjera përkatëse kompetente do t'i kryejnë veprimet nga përgjegjësitë e tyre të caktuara me Statut për zbatimin e këtij plani.

### **Neni 8**

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i Komunes së Prishtinës.

## **KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

**01. nr. 35-1445, më 23.07.2009**

**KRYETARI I KOMUNËS**

**Prof.dr. Isa Mustafa**